



# AKTI I THEMELIMIT

## I

### SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “STUDIO B & L” SH.P.K.

Themeluesit qe firmosin me poshte:

- 1- **Ermal Bleta,**
- 2- **Roland Lika,**
- 3- **Doriana Bleta,**

Qe ne vijim do te quhen **Ortake,**

Sot me date 6/03/2003, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, vendosen te themelojne Shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

#### Kreu I

#### OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK

##### Neni 1. Objekti i shoqerise

Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:

##### 1.1.

- Projektim arkitektonik dhe urbanistik te veprave te ndryshme.
- Konsulence ne fushen e projektimit, te ndertimit dhe te investimeve e programeve per zhvillim.
- Veprimtari ne fushen imobiliare.
- Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe investimeve per ndertim.
- Perfaqesimin e shoqerive te ndryshme shqiptare apo te huaja qe kane objekt te njejte apo te perafert me ate te kesaj shoqerie.



## **Neni 2. Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise**

- 2.1. Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne: **“STUDIO B & L” sh.p.k.**
- 2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Tirane, rruga “Lidhja e Prizrenit”, pall. 4, shk. Nr.1.
- 2.3. Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

## **Neni 3. Rregjimi juridik**


- 3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.
- 3.2. Me vendim te saj, Asambleja e Ortakeve mund te ndryshoje rregjimin juridik te Shoqerise, neqoftese ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.
- 3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
- 3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

#### **Neni 4 Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

- 4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
- 4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

- 
- 4.5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
- 4.6. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### **Neni 5 Kohezgjatja**

- 5.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar 20 vjet.

### **Kreu III**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

#### **Neni 6**

- 6.1. Kapitali themeltar eshte 1000 (nje mije) USD.
- 6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte:

<b>Ermal Bleta</b>	<b>450 USD perkatesisht 45 % te kuotave.</b>
<b>Roland Lika</b>	<b>450 USD perkatesisht 45 % te kuotave.</b>
<b>Doriana Bleta</b>	<b>100 USD perkatesisht 10 % te kuotave.</b>

### **Kreu IV**

#### **ORGANET E SHOQERISE**

#### **Neni 7**

Vendimet ne Shoqeri merren nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar caktohet nga Asambleja e Ortakeve.

### **Kreu V**

#### **ADMINISTRIMI**

#### **Neni 8**

Administrimi i Shoqerise do te behet ne perputhje me Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti.

Kreu VI

**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 9**

- 9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakeve te shoqerise.
- 9.2. Ky Akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

**ORTAKET THEMELUES**

**ERMAL BLETA**

*Ernal Bleta*  
*[Signature]*

**ROLAND LIKA**

*Roland Lika*  
*[Signature]*

**DORIANA BLETA**

*Doriana Bleta*  
*[Signature]*

**Republika e Shqiperise**


**Noteria Tirane**

Nr. 295 Rep.

Nr. 33 Kol.

**VERTETIM**

Vertetohet se sot me 7/03/2003, ne Tirane, para meje Mimoza Papa, Noter Publik me seli ne rrugen "R. Çollaku" pallatet Shallvare, u paraqiten personalisht, z.Ermal Bleta, z.Roland Lika e znj.Doriana Bleta, identifikuar sipas ligjit, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se kane hartuar kete akt jashte kesaj zyre dhe nenshkruan para meje rregullisht. Une, Noteri vertetoj me nenshkrimin tim sipas ligjit.



**NOTERE**

*Mimoza Papa*  
*[Signature]*  
*7/03/2003*



# STATUTI

## I

### SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “STUDIO B & L” SH.P.K.

Themeluesit qe firmosin me poshte:

- 1- **Ermal Bleta,**
- 2- **Roland Lika,**
- 3- **Doriana Bleta,**

Qe ne vijim do te quhen **Ortake,**

Sot me date 6/03/2003, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, vendosen te themelojne Shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

#### Kreu I

#### **OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, RREGJIMI JURIDIK**

##### **Neni 1. Objekti i shoqerise**

Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:

1.1.

- Projektim arkitektonik dhe urbanistik te veprave te ndryshme.



- Konsulence ne fushen e projektimit, te ndertimit dhe te investimeve e programeve per zhvillim.
- Veprimtari ne fushen imobiliare.
- Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe investimeve per ndertim.
- Perfaqesimin e shoqerive te ndryshme shqiptare apo te huaja qe kane objekt te njejte apo te perafert me ate te kesaj shoqerie.

## **Neni 2. Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise**

- 2.1. Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne: **“STUDIO B & L” sh.p.k..**
- 2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Tirane, rruga “Lidhja e Prizrenit”, pall. 4, shk. Nr.1.
- 2.3. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

## **Neni 3. Rregjimi juridik**

- 3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.
- 3.2. Me vendim te saj, Asambleja e Ortakeve mund te ndryshoje rregjimin juridik te Shoqerise, neqoftese ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per fuunksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.
- 3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
- 3.4. Shoqeria do te kete vullen e saj.



## Kreu II

### TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

#### **Neni 4 Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

- 4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
- 4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
- 4.5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
- 4.6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### **Neni 5 Kohezgjatja**

- 5.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar 20 vjet.

## Kreu III

### KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

#### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1000 (nje mije) USD, i vene ne masen 100 % nga Ortaket si me poshte:

<b>Ermal Blea</b>	<b>450 USD perkatesisht 45 % te kuotave.</b>
<b>Roland Lika</b>	<b>450 USD perkatesisht 45 % te kuotave.</b>
<b>Doriana Blea</b>	<b>100 USD perkatesisht 10 % te kuotave.</b>

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre Asambleja e Ortakeve.

Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi qe lejon ligji.

### Kreu III

## **DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE**

### **Neni 7**

- 7.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane dhe ushtron aktivitetin e saj pas regjistrimit si subjekt privat prane organit tatimor.
- 7.2. Emertimi i Shoqerise tregtare, kapitali themeltar, duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve.
- 7.3. Organet kryesore te Shoqerise jane: Asambleja e Ortakeve, Administratori ose administratoret dhe eventualisht Eksperti Kontabel i Autorizuar.

### **Neni 8**

#### **Asambleja e Ortakeve te shoqerise**

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e saj jane te detyrueshme.

Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori, Eksperti Kontabel i Autorizuar ose nga ortaket te cilet zoterojne te pakten 1/10 e kapitalit themeltar te shoqerise. Njoftimi per thirrjen e mbledhjes se Asamblese se Ortakeve behet te pakten 15 perpara dates se mbledhjes, duke parashtruar rendin e dites dhe dokumentacionin qe do te shqyrtohet.

Votat e ortakeve kane vlere proporcionale me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Çdo kuote ka te drejten e nje vote. Çdo ortak mund te perfaqesohet ne Asamble nepermjet nje ortaku tjeter ose nepermjet nje perfaqesuesi, duke qene keta te autorizuar me prokure te posaçme, dhe te marrin vendime vetem per ato çeshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Proces-verbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.



Asambleja e zakonshme merr vendimet me shumicen e votave te ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar.

Asambleja e zakonshme:

- Miraton politiken e pergjithshme te zhvillimit te shoqerise.
- Miraton pjesmarrjen ne shoqeri te tjera.
- Miraton bilancin.
- Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqerise ose ky Statut.

Asambleja e Jashtezakonshme:

Asambleja e Jashtezakonshme merr vendime te vlefshme me 2/3 e votave te ortakeve që zoterojne kuota ne shoqeri.

Asambleja e Jashtezakonshme:

- Vendos për ndryshimet në statut ose të zëvendesoje me një statut të ri këtu statut të shoqerise,
- Vendos zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të shoqerise,
- Vendos për prishjen e shoqerise ose likuidimin e saj,
- Vendos në lidhje për çdo çështje tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit ose ky statut.

Mbledhjet e Asamblese se Jashtezakonshme verbalizohen dhe materialet ruhen në arkivin e shoqerise.

Kreu V

**ADMINISTRIMI**

**Neni 9**

9.1. Administratimi i shoqerise do të bëhet nga Administratoret e saj, z. **Ermal Bleta** dhe z.**Roland Lika**.

9.2. Administratoret kanë të gjitha të drejtat e fuqite për drejtimin e zakonshëm të Shoqerise, me qëllim arritjen e objektivave të saj.

9.3. Administratoreve u takon firma e lirë dhe përfaqesimi i Shoqerise edhe veç e veç.

9.4. Administratorët janë përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës.

9.5. Kompetencat kryesore të administratorit në Shoqëri janë:

- Të miratojë planet e llogarive ekonomike.
- Të miratojë akte normative që përcaktojnë raportet në gjirin e Shoqërisë, duke përfshirë kuadrin e personelin.
- Të përfaqësojë Shoqërinë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e saj.
- Të përcaktojë strukturën e apartatit të Shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- Të për zgjedhë ekspertët kontabel dhe anëtarët e komisionit të likuidimit.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre.

9.6. Administrator mund të zgjidhet edhe një person i cili nuk është ortak i shoqërisë.

## Kreu VI

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

#### Neni 10

10.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht viti i parë i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

10.2. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Asambleja e Ortakëve.

10.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

10.4. Të ardhurat neto të Shoqërisë që rezultojnë nga bilanci do të shpërndahen si vijon: 5% për fondin rezervë, deri sa ky fond të arrijë 1/5 e kapitalit themeltar; pjesa tjetër i takon Ortakëve të shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar.

10.5. Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emëruar për tre vite financiare, me mundësi rizgjedhje, nga Asambleja e Ortakëve.

10.6. Shkarkimi i Ekspertit Kontabel të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast se vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

## Kreu VII

### PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

#### Neni 11

- 11.1. Shoqeria mund te priset ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaket.
- 11.2. Shoqeria hyn ne fazen e likuidimit qysh ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Asambleja e Ortakeve emeron nje ose disa likuidatore, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.
- 11.3. Ne fund te procesit te likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesit dhe mbylljen e procesit te likuidimit.
- 11.4. Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuidatori ndan kapitalet e mbetura per Ortaket e shoqerise.

## Kreu VIII


### DISPOZITA TE FUNDIT

#### Neni 12


- 12.1. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do t'i bhet referim Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe legjislacionit koherent.
- 12.2. Ky Statut hartohet ne kater kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

### ORTAKET E SHOQERISE

**ERMAL BLETA**

*Ermaf Bleta*  


**ROLAND LIKA**

*Rolandal Lika*  


**DORIANA BLETA**

*Doriane Bleta*  
